




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep.	Nr. Prot.
Dip.	Br. Prot.
Dep.	Prot No.
Nr. Ifaq.	01-1890/14
Broj stranica	
Nr. pages	02
PRISHTINE	
27.05.2014	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.05.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-3723-13 për z. Sylejman Kerolli – Zyrtar kryesor financiar dhe i thesarit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, për shkak se është shmangur situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-3723-13, për Zyrtarin e lartë, z. Sylejman Kerolli – Zyrtar kryesor financiar dhe i thesarit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z. Sylejman Kerolli fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtaret e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Kerolli, është deklaruar se do t'i bëjë këto ndryshimet e kërkuara për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z. Kerolli, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK-03-1161-14) në të cilën shihet se te biznesi privat, "AL & BS Construction" sh.p.k., z. Kerolli, pronar ka emruar një "person të besuar" në funksionin e personit të autorizur, ashtu siç e parasheh edhe ligji, duke parandaluar kështu konfliktin e interesit me funksionin e tij publik– Zyrtar kryesor financiar dhe i thesarit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrتari i lartë publik
- Drejtore i DPK-së
- Z./znej. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znej. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

